
**VENDIM I KËSHILLIT, DATË 14 MAJ 2008, "PËR KRIJIMIN E NJË RRJETI
EVROPIAN TË MIGRACIONIT"**

(2008/381/KE)

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti nenin 66 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian¹,

Meqë:

1. Në vitin 2003, Komisioni krijoi masa përgatitore trevjeçare për krijimin e një Rrjeti Evropian të Migracionit (EMN), me qëllim që t'i ofronte Komunitetit dhe shteteve anëtare të saj të dhëna objektive, të besueshme dhe të përditësuara për migracionin.

2. Këshilli Evropian, në mbledhjen e tij në Selanik në qershor të vitit 2003, duke marrë parasysh rëndësinë e monitorimit dhe analizimit të fenomenit të migrimit shumëdimensional, mirëpriti në konkluzionet e tij krijimin e EMN-së dhe deklaroi se do të shqyrtonte mundësinë e krijimit të një strukture të përhershme në të ardhmen.

3. Më 4 nëntor të vitit 2004, Këshilli Evropian miratoi një program shumëvjeçar për forcimin e fushës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, i njohur si Programi i Hagës, i cili bën thirrje për zhvillimin e fazës së dytë të një politike të përbashkët në fushën e azilit, migrimit, vizave dhe kufijve, duke filluar nga 1 maji 2004, duke u bazuar, ndër të tjera, në një bashkëpunim më të ngushtë praktik midis shteteve anëtare dhe në një shkëmbim më të mirë informacioni. Programi i Hagës pranon se "Zhvillimi i vazhdueshëm i politikës evropiane për azilin dhe migracionin duhet të bazohet në një analizë të përbashkët të fenomeneve migratore në të gjitha aspektet e tyre. Përforcimi i mbledhjes, ofrimit, shkëmbimit dhe përdorimit efikas të informacionit dhe të të dhënave të përditësuara për të gjitha zhvillimet migratore përkatëse është me rëndësi kyçe".

4. Në mënyrë që të konsultohet me palët përkatëse të interesuara për të ardhmen e EMN-së, më 28 nëntor 2005 Komisioni miratoi një "Dokument të Gjelbër për të ardhmen e Rrjetit Evropian të Migracionit", i cili përveç vlerësimit të funksionimit të EMN-së gjatë viteve të para të periudhës përgatitore, trajtoi edhe çështje të tilla si mandati dhe struktura e ardhshme e EMN-së.

5. Konsultimi me publikun tregoi se shumica e palëve të interesuara janë në favor të vazhdimit dhe fuqizimit të veprimtarive të EMN-së dhe të ruajtjes së objektivit fillestar të EMN-së, që është ofrimi i informacionit të përditësuar, objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm mbi çështjet e migracionit dhe azilit. Gjithashtu, u vu re se shumica e palëve të interesuara dëshironin të ruanin lidhjen e EMN-së me Komisionin.

6. EMN-ja duhet të shmangë dublikimin e punës së instrumenteve ose strukturave ekzistuese të Komunitetit, qëllimi i të cilave është mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit në fushat e migracionit dhe azilit, dhe duhet të ofrojë një vlerë të shtuar krahasuar me to, veçanërisht nëpërmjet fushëveprimit të gjerë të detyrave të saj, një fokus më të madh në analiza, lidhje me komunitetin akademik dhe disponueshmëri publike të rezultateve të saj.

7. Ndër instrumentet dhe strukturat e tjera ekzistuese, Rregullorja (KE) nr. 862/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 korrik 2007, "Për statistikën e Komunitetit për migrimin dhe mbrojtjen ndërkombëtare"² përbën një kuadër të rëndësishëm referimi për funksionimin e rrjetit evropian të migracionit. Vëmendje duhet t'i kushtohet dhe punës së vlefshme të kryer nga Qendra për Informim, Diskutim dhe Shkëmbim për Kalimin e Kufijve dhe Imigracionin (Cirefi) dhe dispozitave të Vendimit të Këshillit 2005/267/KE, datë 16 mars 2005, "Për krijimin e një rrjeti të sigurt informacioni dhe koordinimi përmes internetit për shërbimet e menaxhimit të migracionit të shteteve anëtare"³.

8. Për të arritur objektivat e saj, EMN-ja duhet të përkrahet nga një "pikë kombëtare kontakti" në çdo shtet anëtar. Veprimtaritë e "pikës kombëtare të kontaktit" duhet të koordinohen në nivel BE-je nga Komisioni, i asistuar nga një ofrues shërbimesh me ekspertizën e duhur për të organizuar punën e përditshme të EMN-së, duke përfshirë dhe sistemin e saj të shkëmbimit të informacionit.

9. Për të garantuar që pikat kombëtare të kontaktit të kenë ekspertizën e nevojshme për t'u marrë me aspekte shumëdimensionale të çështjeve të migracionit dhe azilit, ato duhet të përbëhen nga së paku tre ekspertë, të cilët individualisht ose së bashku të kenë kompetenca në hartimin e politikave, ligjit, hulumtimeve dhe statistikave. Këta ekspertë mund të vijnë nga administratat e shteteve anëtare ose nga ndonjë organizatë tjetër. Çdo pikë kombëtare kontakti duhet gjithashtu të ketë kolektivisht ekspertizë të duhur në teknologjinë e informacionit, në krijimin e skemave të bashkëpunimit dhe rrjetëzimit me organizatat dhe subjektet e tjera kombëtare, si dhe në bashkëpunimin në një mjedis shumëgjuhësh në nivel evropian.

10. Çdo pikë kontakti kombëtare duhet të krijojë një rrjet kombëtar të migracionit, të përbërë nga organizata dhe individë aktivë në fushën e migracionit dhe azilit dhe duke përfshirë për shembull, universitetet, organizatat kërkimore dhe kërkuesit, organizatat qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare në mënyrë që të dëgjohen të gjitha palët përkatëse të interesit.

11. "Bordi Drejtues" duhet t'i japë udhëzime politike EMN-së, si dhe kontribut në përgatitjen dhe miratimin e programit vjetor të veprimtarive të EMN-së.

12. Për të mundësuar shpërndarjen më të gjerë të informacionit të nxjerrë nga EMN-ja në formën e studimeve dhe raporteve, ky informacion të jetë i disponueshëm përmes mjeteve teknologjike më të përparuara, duke përfshirë një faqe interneti të dedikuar.

13. Kur është e nevojshme për arritjen e objektivave të saj, EMN-ja duhet të jetë në gjendje të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me subjekte të tjera aktive në fushën e migracionit dhe azilit. Në krijimin e këtyre marrëdhënieve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurimit të një shkalle të mirë bashkëpunimi me subjektet në Danimarkë, Island, Norvegji, Zvicër, në

vendet kandidate për anëtarësim, në vendet e mbuluara nga Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe në Rusi.

14. EMN-ja duhet të bashkëfinancohet përmes granteve nga Komisioni, në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002, datë 25 qershor 2002; Rregullorja financiare që zbatohet për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve evropiane⁴.

15. Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 tetorit 1995 për mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave⁵ dhe Rregullorja (KE) nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 dhjetorit 2000 për mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave⁶ duhet të mbahet parasysh në kuadër të sistemit të shërbimit të informacionit të EMN-së.

16. Në përputhje me nenin 3 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Irlandës, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Mbretëria e Bashkuar ka njoftuar dëshirën e saj për të marrë pjesë në miratimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

17. Në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Protokollit për qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, si dhe pa cenuar nenin 4 të këtij protokollit, Irlanda nuk merr pjesë në miratimin e këtij vendimi dhe nuk është e detyruara ta zbatojë atë apo të jetë objekt i zbatimit të tij.

18. Në përputhje me nenin 1 dhe 2 të Protokollit për qëndrimin e Danimarkës, bashkëlidhur Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e këtij vendimi dhe nuk është e detyruar ta zbatojë atë apo të jetë objekt i zbatimit të saj,

MIRATON KËTË VENDIM:

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Krijohet Rrjeti Evropian i Migracionit ("EMN").

2. Objektivi i EMN-së është përmbushja e nevojave për informacion të institucioneve të Komunitetit dhe të autoriteteve dhe institucioneve të shteteve anëtare për migracionin dhe azilin, duke ofruar informacion të përditësuar, objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm mbi migracionin dhe azilin, me synimin për të mbështetur hartimin e politikave në Bashkimin Evropian në këto fusha.

3. EMN-ja shërben gjithashtu për t'i ofruar publikut të gjerë informacion mbi këto çështje.

Neni 2

Detyrat

1. Për arritjen e objektivave të përmendura në nenin 1, EMN-ja:

a) mbledh dhe shkëmben të dhëna dhe informacione të përditësuara dhe të besueshme nga një gamë e gjerë burimesh;

b) ndërmerri analiza të të dhënave dhe informacionit të përmendur në gjuhën "a" dhe i ofron ato në një format të gatshëm për t'u përdorur;

c) në bashkëpunim me organet e tjera përkatëse të BE-së, kontribuon në zhvillimin e treguesve dhe kritereve që do të përmirësojnë konsistencën e informacionit dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e veprimtarive të BE-së lidhur me statistikat migracionit;

d) harton dhe publikon raporte periodike për situatën e migracionit dhe azilit në BE dhe shtetet anëtare;

e) krijon dhe ruan një sistem të shkëmbimit të informacionit në internet, i cili siguron akses në dokumente dhe publikime përkatëse në fushën e migracionit dhe azilit;

f) rrit ndërgjegjësimin e vetë, duke siguruar akses në informacionin që mbledh dhe duke shpërndarë rezultatet e EMN-së, përveç nëse ky informacion është i një natyre konfidenciale;

g) koordinon informacionin dhe bashkëpunon me organe të tjera përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

2. EMN-ja garanton që veprimtaritë e saj të jenë në përputhje me dhe të koordinuara me instrumentet dhe strukturat përkatëse të BE-së në fushën e migracionit dhe azilit.

Neni 3

Përbërja

EMN-ja përbëhet nga:

— Pikat kombëtare të kontaktit të caktuara nga shtetet anëtare,

— Komisioni.

Neni 4

Bordi drejtues

1. EMN-ja udhëhiqet nga bordi drejtues i përbërë nga një përfaqësues i çdo shteti anëtar dhe një përfaqësues i Komisionit të asistuar nga dy ekspertë shkencorë.

2. Përfaqësuesi i komisionit vepron si Kryetar i bordit drejtues.

3. Çdo anëtar i bordit drejtues zotëron një votë, përfshirë dhe Kryetari. Vendimet merren me një shumicë prej dy të tretës së votave.

4. Një përfaqësues i Parlamentit Evropian mund të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e bordit drejtues.

5. Në veçanti, bordi drejtues:

a) kontribuon në përgatitjen dhe miratimin e programit vjetor të veprimtarive të EMN-së, duke përfshirë një shumë treguese të buxhetit minimal ose maksimal për çdo pikë kombëtare kontakti, e cila siguron mbulimin e kostove bazë për funksionimin e duhur të rrjetit, në përputhje me nenin 5, në bazë të një drafti të hartuar nga Kryetari;

b) shqyrton progresin e arritur nga EMN-ja, duke dhënë rekomandime për masa të nevojshme, kur nevojiten;

c) të paktën një herë në vit, i siguron një raport të përmbledhur të statusit Parlamentit Evropian, Këshillit, Komisionit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve lidhur me ecurinë e veprimtarive të EMN-së dhe konstatimet kryesore nga studimet e tij;

d) identifikon marrëdhëniet më përshtatshme bashkëpunuese e strategjike me subjektet e tjera kompetente në fushën e migracionit dhe azilit dhe, kur është e nevojshme, miraton masat administrative për këtë bashkëpunim, siç përmendet në nenin 10;

e) këshillon pikat kombëtare të kontaktit se si të përmirësojnë veprimet e tyre dhe i ndihmon ato të ndërmarrin masat e nevojshme kur mangësitë e vazhdueshme të identifikuara në punën e një pike kombëtare të kontaktit mund të kenë pasoja negative në punën e EMN-së.

6. Bordi drejtues miraton rregulloren e tij të brendshme dhe mbledhet të paktën dy herë në vit nga Kryetari i tij.

Neni 5

Pikat kombëtare të kontaktit

1. Çdo shtet anëtar cakton një subjekt, i cili vepron si pika e tij kombëtare e kontaktit. Për të lehtësuar punën e EMN-së dhe për të siguruar arritjen e objektivave të saj, shtetet anëtare, kur është e nevojshme, marrin në konsideratë nevojën për një koordinim ndërmjet përfaqësuesve të tyre në Bordin Drejtues dhe pikave të tyre kombëtare të kontaktit.

2. Pika kombëtare e kontaktit përbëhet të paktën nga tre ekspertë. Njëri prej këtyre ekspertëve, i cili vepron si koordinator kombëtar, është zyrtar ose punonjës i subjektit të caktuar. Ekspertët e tjerë mund të jenë ose nga i njëjti subjekt ose nga organizata të tjera publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare të regjistruara në shtetin anëtar.

3. Ekspertët e secilës pikë kombëtare të kontaktit kanë të gjithë ekspertizë në fushën e azilit dhe migracionit, duke mbuluar aspektet e hartimit të politikave, ligjit, hulumtimeve dhe statistikave.

4. Shtetet anëtare informojnë Komisionin, jo më vonë se tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ekspertët të cilët përbëjnë pikat kombëtare të kontaktit, duke specifikuar se si këto të fundit i përgjigjen kërkesave të përcaktuara në paragrafin 3.

5. Pikat kombëtare të kontaktit kryejnë detyrat e EMN-së në nivel kombëtar dhe në veçanti:

- a) ofrojnë raporte kombëtare, duke përfshirë raportet e përmendura në nenin 9;
- b) kontribuojnë me informacion kombëtar në sistemin e shkëmbimit të informacionit të përmendur në nenin 8;
- c) zhvillojnë një kapacitet për lëshimin e kërkesave të posaçme dhe për t'iu përgjigjur menjëherë këtyre kërkesave nga pikat e tjera kombëtare të kontaktit;
- d) Krijojnë një rrjet kombëtar të migracionit, të përbërë nga një gamë e gjerë organizatash dhe individësh aktivë në fushën e migracionit dhe azilit dhe përfaqësimin e palëve përkatëse të interesuara. Anëtarëve të rrjetit kombëtar të migracionit mund t'ju kërkohej që të kontribuojnë në veprimtaritë e EMN-së, veçanërisht në lidhje me nenet 8 dhe 9.

6. Ekspertët e secilës pikë kombëtare të kontaktit mblidhen rregullisht, sipas rastit, edhe me anëtarët e rrjeteve kombëtare të migracionit të përmendur në paragrafin 5, germa "d", për të diskutuar punën e tyre dhe për të shkëmbyer informacion rreth veprimtarive në vazhdim dhe të ardhshme.

Neni 6

Koordinimi

1. Komisioni koordinon punën e EMN-së, gjithashtu në përputhje me nenin 2, paragrafi 2, dhe garanton që ajo të pasqyrojë në mënyrën e duhur prioritetet politike të BE-së në fushën e migracionit dhe azilit.

2. Për organizimin e punës së EMN-së, Komisioni asistohet nga një ofrues shërbimesh i përzgjedhur sipas një procedure prokurimi. Ofruesi i shërbimeve përbush kërkesat e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 3 dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse të përcaktuar nga Komisioni.

3. Nën mbikëqyrjen e Komisionit, ofruesi i shërbimit, ndër të tjera:

- a) organizon punën e përditshme të EMN-së;
- b) krijon dhe menaxhon sistemin e shkëmbimit të informacionit të përmendur në nenin 8;
- c) koordinon kontributin e pikave kombëtare të kontaktit;
- d) përgatit mbledhjet e përmendura në nenin 7;
- e) Përgatit përpilimet dhe sintezat e raporteve dhe studimeve të përmendura në nenin 9.

4. Pas konsultimit me pikat kombëtare të kontaktit dhe pas miratimit nga bordi drejtues, Komisioni, brenda kufijve të objektivit të përgjithshëm dhe detyrave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2, miraton programin vjetor të veprimtarive të EMN-së. Programi specifikon objektivat dhe prioritetet tematike. Komisioni monitoron zbatimin e programit vjetor të veprimtarive dhe i raporton rregullisht bordit drejtues zbatimin e tij dhe zhvillimin e EMN-së.

5. Pas këshillimit nga bordi drejtues i përmendur në nenin 4, paragrafi 5, germa "e", Komisioni ndërmerr masat e nevojshme në bazë të marrëveshjeve të granteve të përmendura në paragrafin 6 të këtij neni.

6. Në bazë të programit vjetor të veprimtarive të EMN-së, Komisioni përcakton shumat treguese të disponueshme për grante dhe kontrata në kuadrin e një vendimi financimi, në përputhje me nenin 75 të Rregullores (KE, Euratom) nr. 1605/2002.

7. Komisioni i jep grantet operative pikave kombëtare të kontaktit që përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2 dhe 3, në bazë të aplikimeve përkatëse për grante të paraqitura nga to. Bashkëfinancimi maksimal i BE-së jepet deri në masën 80 % të totalit të kostove të pranueshme.

8. Në përputhje me nenin 113, paragrafi 2 i Rregullores (KE, Euratom) nr. 1605/2002, grantet nuk janë objekt rinovimi sipas parimit të zbritjes graduale.

Neni 7

Mbledhjet

1. EMN-ja mblidhet zakonisht të paktën pesë herë në vit.
2. Në mbledhjet e EMN-së, çdo pikë kombëtare e kontaktit përfaqësohet nga të paktën një prej ekspertëve të saj. Në mbledhje marrin pjesë jo më shumë se tre ekspertë nga çdo pikë kombëtare e kontaktit.
3. Mbledhjet e EMN-së thirren dhe mblidhen nga një përfaqësues i Komisionit.
4. Qëllimi i mbledhjeve periodike të EMN-së është:
 - a) t'ju mundësohet pikave kombëtare të kontaktit shkëmbimi i njohurive dhe përvojës, veçanërisht në lidhje me funksionimin e EMN-së;
 - b) të rishikohet progresi i punës së EMN-së, dhe në veçanti përgatitja e raporteve dhe studimeve të përmendura në nenin 9;
 - c) të shkëmbehen informacione dhe pikëpamje, në veçanti mbi strukturën, organizimin, përmbajtjen dhe qasjen në informacionin e disponueshëm të përmendur në nenin 8;
 - d) të ofrohet një platformë për diskutimin e problemeve praktike dhe ligjore që hasen nga shtetet anëtare në fushën e migracionit dhe azilit, në veçanti diskutimin e kërkesave të posaçme të përmendura në nenin 5, paragrafi 5.

e) këshillimi me pikat kombëtare të kontaktit për zhvillimin e programit vjetor të veprimtarive të EMN-së të përmendura në nenin 6, paragrafi 4.

5. Ekspertët dhe subjektet që nuk janë anëtarë të EMN-së mund të ftohen në mbledhjet e saj, nëse prania e tyre konsiderohet e dëshirueshme. Gjithashtu mund të organizohen takime të përbashkëta me rrjete apo organizata të tjera.

6. Nëse veprimtaritë e përmendura në paragrafin 5 nuk janë planifikuar në programin vjetor të veprimtarive të EMN-së, ato i komunikohen në kohë pikave kombëtare të kontaktit.

Neni 8

Sistemi i shkëmbimit të informacionit

1. Në përputhje me këtë nen ngrihet një sistem të shkëmbimit të informacionit në internet, i aksesueshëm përmes një faqeje interneti të dedikuar.

2. Përmbajtja e sistemit të shkëmbimit të informacionit normalisht është publike.

Pa cenuar Rregulloren (KE) nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 maj 2001, "Për të drejtën e aksesit të publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit"⁷, qasja në informacionin konfidencial kufizohet vetëm në anëtarët e EMN-së.

3. Sistemi i shkëmbimit të informacionit përfshin së paku elementet e mëposhtme:

a) qasjen në legjislacionin e BE-së dhe të brendshëm, në praktikën gjyqësore dhe në zhvillimet e politikave në fushat e migracionit dhe azilit;

b) funksionalitetin për kërkesat e posaçme, siç përmendet në nenin 5, paragrafi 5, germa "c";

c) një fjalor dhe enciklopedi për migracionin dhe azilin;

d) akses të menjëhershëm në botimet e EMN-së, duke përfshirë raportet dhe studimet e përmendura në nenin 9, si dhe një buletin të rregullt;

e) një direktori të hulumtuesve dhe institucioneve kërkimore në fushën e migracionit dhe azilit.

4. Për qëllime të aksesit në informacionin e përmendur në paragrafin 3, EMN-ja, kur është e nevojshme, mund të shtojë lidhje në faqet e tjera ku gjendet informacioni origjinal.

5. Faqja e dedikuar e internetit lehtëson aksesin në iniciativa të krahasueshme të informimit publik në çështje të lidhura me to dhe në faqet që përmbajnë informacion në lidhje me gjendjen e migracionit dhe azilit të shteteve anëtare dhe të vendeve të treta.

Neni 9

Raportet dhe studimet

1. Çdo pikë kombëtare e kontaktit ofron çdo vit një raport përshkrues të situatës së migracionit dhe azilit në shtetin anëtar, ku përfshihen dhe zhvillimet e politikave dhe të dhënat statistikore.

2. Programi vjetor i veprimtarive përfshin përgatitjen e studimeve të tjera nga çdo pikë kombëtare e kontaktit, duke ndjekur specifikimet e përbashkëta, që mbulojnë çështjet specifike të migracionit dhe azilit të nevojshme për mbështetjen e hartimit të politikave.

Neni 10

Bashkëpunimi me subjektet e tjera

1. EMN-ja bashkëpunon me subjektet në shtetet anëtare dhe në vendet e treta, si dhe me agjencitë e BE-së dhe organizatat ndërkombëtare kompetente në fushën e migracionit dhe azilit.

2. Marrëveshjet administrative për bashkëpunimin e përmendur në paragrafin 1, ku mund të përfshihet, sipas nevojës, lidhja e marrëveshjeve nga Komisioni në emër të BE-së, i nënshtrohen miratimit nga bordi drejtues.

Neni 11

Burimet buxhetore

Burimet buxhetore të ndara për veprimet e parashikuara në këtë vendim regjistrohen në ndarjet vjetore të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian. Shuma e caktuar vjetore në dispozicion autorizohet nga autoriteti buxhetor brenda kufijve të kuadrit financiar.

Neni 12

Vënia në zbatim e buxhetit

Komisioni e vë në zbatim përkrahjen financiare të Komunitetit në përputhje me Rregulloren (KE, Euratom) nr. 1605/2002.

Neni 13

Rishikimi

Jo më vonë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe më pas çdo tre vjet, Komisioni i paraqet Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve një raport për zhvillimin e EMN-së të bazuar në një vlerësim të jashtëm dhe të pavarur. Ky raport shoqërohet me propozime për ndryshime, nëse është e nevojshme.

Neni 14

Publikimi dhe data e zbatimit

Ky vendim zbatohet nga data e botimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 15

Marrësit

Ky vendim u drejtohet shteteve anëtare në përputhje me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 14 maj 2008.

Për Këshillin

Presidenti

A. BAJUK

-
1. Opinion i 10 prillit 2008 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare).
 2. *Gazeta Zyrtare L 199, 31.7.2007, f. 23.*
 3. *Gazeta Zyrtare L 83, 1.4.2005, f. 48.*
 4. *Gazeta Zyrtare L 248, 16.9.2002, f. 1.* Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1525/2007 (*Gazeta Zyrtare L 343, 27.12.2007, f. 9.*)
 5. *Gazeta Zyrtare L 281, 23.11.1995, f. 31.* Direktiva e ndryshuar me Rregulloren (KE) Nr. 1882/2003 (*Gazeta Zyrtare L 284, 31.10.2003, f. 1.*)
 6. *Gazeta Zyrtare L 8, 12.1.2001, f. 1.*
 7. *Gazeta Zyrtare L 145, 31.5.2001, f. 43.*
-